



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:116400
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05371126

Ac.nr.84/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare, Nora Bllaca Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.H., dhe Xh.H., nga fshati Z....., Komuna Pejë, të cilët me autorizim i përfaqëson T.Zh., avokate nga Prishtina, kundër të paditurave M.P., G.H., dhe G.H., nga fshati Z....., Komuna Pejë, të cilat me autorizim i përfaqëson S.B., avokat nga Peja, sipas kontestit për pengim të posedimit, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësueses të autorizuar të paditësve, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2062/2023 të datës 14.11.2023, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 22.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditësve S.H., dhe Xh.H., nga fshati Z....., Komuna Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2062/2023 i datës 14.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.2062/2023 të datës 14.11.2023, ka vendosur si vijon:

‘I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve S.H., dhe Xh.H., nga fshati Z....., K-Pejë, me të cilën kanë kërkuar që të VËRTETOHET se të paditurat M.P., G.H., dhe G.H., nga fshati Z....., K-Pejë i kanë penguar paditësit me datë 29.06.2022, në posedimin faktik të lirë të shtëpisë, e cila gjendet në fshatin Z....., K-Pejë, në sipërfaqe prej 200m², të URDHËROHEN të paditurat M.P., G.H., dhe G.H., nga fshati Z....., K-Pejë që menjëherë ta ndërpresin aktin e pengim

posedimit, të përmbahen në të ardhmen nga veprimet që i pengojnë paditësit në posedimin dhe shfrytëzimin e shtëpisë të lartcekur, të përmbahen nga çfarëdo akti i tillë apo i ngjashëm, të mos e ndërrojnë gjendjen faktike të shtëpisë si dhe të mos prekin asgjë që gjendet në pronën e paditësve, pa autorizimin e tyre si dhe të OBLIGOHEN të paditurat në kompensimin e shpenzimeve të procedurës në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm, si e PABAZUAR.

II. REFUZOHET *kërkesëpadia e paditësve S.H., dhe Xh.H., nga fshati Z..... K-Pejë, me të cilën kanë kërkuar që të caktohet masa e sigurisë dhe të URDHËROHEN të paditurat M.P., G.H., dhe G.H., nga fshati Z....., K-Pejë që të pushojnë së penguari paditësit në shfrytëzimin e shtëpisë dhe kryerjen e aktiviteteve të caktuara, ashtu që të mos e ndryshojnë gjendjen ekzistuese të shtëpisë që gjendet në fshatin Z....., K-Pejë, si e PABAZUAR.*

III. DETYROHEN *paditësit S.H., dhe Xh.H., nga fshati Z....., K-Pejë, që të paditurave M.P., G.H., dhe G.H., nga fshati Z....., K-Pejë, t'ua paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën prej 742.00€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë''.*

Kundër këtij aktvendimi paditësit nëpërmes të autorizuarës në afatin e paraparë ligjor kanë paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar si të bazuar ankesën e paditësve, të anuloj aktvendimin e atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose i njëjtit të ndryshohet në atë mënyrë që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurave me përgjigje në ankesë, ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditësve si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- **Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit S.H., dhe Xh.H., përmes përfaqësueses të autorizuar, me datë 24.05.2023, kanë ushtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurave M.P., G.H., dhe G.H., për pengim të posedimit. Në padi kanë theksuar se paditësit janë pronarë të shtëpisë që gjendet në fshatin Z....., Komuna Pejë, në sipërfaqe prej rreth 200m², se jetojnë në shtetin e Norvegjisë, ndërsa pushimet i kalojnë në shtetin e Kosovës dhe pikërisht në shtëpinë e tyre në Z....., të cilën e kanë ndërtuar me të ardhurat që i kanë realizuar jashtë vendi dhe në të cilën kanë investuar vazhdimisht përgjatë viteve, ashtu që e kanë shfrytëzuar sa herë kanë ardhur në Kosovë, ndërsa me datë 29.06.2022, kur paditësit kanë ardhur në Kosovës, dhe kanë tentuar për të hyrë në shtëpinë e tyre, kanë filluar problemet dhe të paditurat i kanë larguar nga shtëpia,

duke thënë se shtëpia tani iu takon atyre dhe është në pronësi të tyre, kështu që të paditurat në mënyrë të kundërligjshme e kanë uzurpuar shtëpinë dhe nuk i lejojnë paditësit që ta shfrytëzojnë shtëpinë e tyre ashtu siç e kanë shfrytëzuar deri më tani. Kanë kërkuar nga gjykata që të vërtetohet pengimi i posedimit të pronës së paditësve si më lartë dhe të detyrohen të paditurat ta ndërpresin aktin e pengim posedimit, të përmbahen në të ardhmen nga veprimet që i pengojnë paditësit në posedimin dhe shfrytëzimin e shtëpisë të lartcekur, të mos e ndërrojnë gjendjen faktike të shtëpisë si dhe të mos prekin asgjë që gjendet në pronën e paditësve, pa autorizimin e tyre.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar dhe mbajtur seancat gjyqësor dhe ka administruar provat ne seancën e shqyrtimit kryesor, më pas ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka vërtetuar se kontesti midis palëve ka lindur si rezultat i mosmarrëveshjeve pronësore, dhe se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të pengim posedimit, sepse veprimet e të paditurave nuk mund të trajtohen si akt i pengim posedimit edhe pse paditësit kanë pretenduar që janë penguar nga të paditurat për të hyrë në shtëpi me datë 29.06.2022, dhe në vazhdimësi nuk po i lejojnë për të hyrë në shtëpi, gjykata ka ardhur në përfundim se përveç se kërkesë padia e paditësve është e pa bazuar, kërkesëpadia e paditësve është e paafatshme, dhe kjo rrethanë fare nuk është kontestuese, sepse paditësit nuk janë lejuar që të hyjnë në shtëpinë në fshatin Z....., Pejë, që nga muaji Qershor i vitit 2022, ndërsa padinë e kanë ushtruar në gjykatë me datë 24.05.2023, pra paditësit kanë ushtruar padinë pas kalimit të afatit subjektiv, në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 114 të LPDTS-së, ndaj ka ardhur në përfundim se padia e paditësve është e pabazuar. Gjykata ka refuzuar edhe propozimin për caktimin e masës së sigurimi, pasi që ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjor në kuptim të dispozitave të nenin 297 par.1 pika a dhe b të LPK-së. Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në dispozitat e nenit 452.1 dhe nenit 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësve për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktvendimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm dhe i hartuar në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 160, lidhur me nenin 175 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Në anën tjetër, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, të cilat arsye janë të pranueshme

edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërbërje, ndërsa nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktvendimit.

Gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Andaj pretendimet mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në procedurën për shkak të pengim posedimit si objekt shqyrtimit është mbrojtja e posedimit nga marrja dhe shqetësimi si dhe rivendosja e gjendjes së posedimit. Kjo do të thotë se me padi për pengim posedim mbajtësi faktik i sendit mund të kërkojë nga gjykata që të vërtetojë ekzistimin e aktit të pengim posedimit të sendit apo të së drejtës, që ta urdhërojë të paditurin që të rivendosë gjendjen e posedimit, ashtu siç ka qenë para kryerjes së aktit të pengim posedimit dhe ti ndalojë të paditurit ndërmarrjen e veprimit të njëjtë apo të ngjashëm në të ardhmen. Në rastin konkret, paditësit nuk kanë argumentuar faktin se kanë qenë në posedimin e fundit të shtëpisë e cila gjendet në fshatin Z....., Komuna Pejë, siç u kuptua nga referati i padisë dhe deklaratimet e tyre gjatë procedurës së zhvilluar. Për më tepër padia e paditësve është e pabazuar edhe nga fakti se paditësit kanë ushtruar padinë pas kalimit të afatit subjektiv, në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 114 të LPDTS-së, që kjo rrethanë është vërtetuar si në pretendimet në padi ashtu edhe gjatë deklaratimit të paditësit Xh.H., në cilësi të palës. Në kuptim të lartcekurve rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësve për pengim posedim, si dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për një masë të tillë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës paditëse të theksuara në ankesën e parashtruar, ku paditësit nuk kanë ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, pretendimet e paditësve do të mund të shërbenin në ndonjë procedurë tjetër, por në procedurën e pengim posedimit në rastin konkret nuk është vërtetuar se të paditurit kanë ndërmarrë ndonjë veprim me të cilin do të vërtetohej akti i pengim posedimit.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata, me të drejtë, është mbështetur në nenin 452, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga ajo që është vendosur.

Nga sa u tha me lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

Numri i lëndës: 2023:116400
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05371126

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.84/2024, me datë 22.02.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti d.v,